

Rezultatet e anketave mbi problematikat mjedisore në qytetin e Krujës

Përgatitur nga: Milieukontakt, Shqipëri

Mbështetur nga: Programi SENiOR-II



Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri

PËRMBAJTJA:

I. Qëllimi	3
II. Metodologjia	3
III. Analiza e mostrës	4
IV. Rezultatet e sondazhit	5
Uji:	6
Ajri:	7
Ndotja akustike:	8
Hapësirat e gjelbra:	8
Mbetjet urbane:	9
Ndryshimet klimatike:	10
Gjetje dhe rekomandime	11
V.G Rezultatet e anketës për problematikat mjedisore në qytetin e Krujës	15

I. Qëllimi

Në kuadër të projektit “*Informim-Komunikimi mbi politikat mjedisore për zhvillim të qëndrueshëm*”, mbështetur nga programi SENiOR–II, Milieukontakt Shqipëri në bashkëpunim me organizatat e rrjetit ECIM¹ ka realizuar “Anketimin mbi problematikat mjedisore” me qëllim kryesor vlerësimin e situatës së politikave dhe shërbimeve mjedisore nga komuniteti, në njësitë vendore të përzgjedhura. Nëpërmjet analizës së rezultateve të dala nga anketimi, studimi realizon një vlerësim të nivelit aktual të problematikave mjedisore, identifikohen fushat për ndërhyrje sipas prioriteteve, nevojave dhe shpërndarjes territoriale.

Anketimi i siguron organizmave publike dhe private, lokale dhe kombëtare, të dhëna dhe elemente të rëndësishme për rekomandime në hartim politikash, ndërhyrjesh, si dhe shërben si orientues në procesin e hartimit apo rishikimit të projekteve në funksion të nevojave aktuale praktike dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Rezultatet e anketës do t’i paraqiten bashkive përkatëse, duke kërkuar adresimin e problematikave, por edhe ofruar ndihmën dhe ekspertizën e organizatave të grupimit në ndërgjegjësimin e publikut dhe aktorëve të tjerë si dhe në zgjidhjen e problemeve lokale.

II. Metodologjia

Nga pikëpamja metodologjike, studimi ka synuar përcaktimin e saktë të bazës së hulumtimit, parametrat matës, si dhe përfundimet e alternativave të përgjigjeve. Në fazën e hartimit të anketës, për identifikimin e problematikës, është ndjekur dhe tentuar të arrihet në një lloj hulumtimi me një qasje të thjeshtë, por cilësore në një kontekst praktik dhe real, bazuar kryesisht në metodën e kontaktimit direkt me të anketuarit.

Zgjedhja e formatit të anketimit dhe llojit e të dhënave të kërkuara, është përputhur me mënyrën sesi do përpunohen ato në studim, sipas shkallëve të matjes cilësore dhe sasiore, të hartuara në mundësinë e përgjigjeve alternative në anketë. Anketa është e ndarë në 6 seksione sipas fushave të përfshira në studim dhe përmban gjithsej 24 pyetje. Formulimi i pyetjeve është bazuar dhe ka ndjekur identifikimin e problematikave nga grupi i projektit, me një gjuhë të thjeshtë, të kuptueshme, me qëllim marrjen e opinionit të grupeve të ndryshme nga komuniteti i anketuar.

Ky proces u realizua në 4 faza:

Faza e I-rë- Identifikimi i problematikave mjedisore (1 ditë) nga grupi i projektit;

Faza e II-të- Vendosja e kontakteve me kordinatorët vendorë dhe realizimi i pyetsorëve (1 ditë)

Faza e III-të -Hedhja e të dhënave të anketës dhe përpunimi i draft analizës për 7-bashkitë (6 ditë)

Faza e IV-të-Përgatitja e analizës, gjetjeve dhe raportit për anketën (4 ditë)

¹ Anëtarë të rrjetit ECIM: Qendra grupimi Ekolëvizja, Milieukontakt Shqipëri, Forumi i Mendimit të Lirë, Together for Life, Egnatia, SEEP, EcoMjedisi dhe AJMMI.

Qytetet ku u realizua anketimi ishin:

- Saranda,
- Përmeti,
- Lezha
- Kruja,
- Librazhdi,
- Gramshi
- Elbasani.

Studimi u bazua në sondazhin e drejtpërdrejtë me anë të një pyetësoi të strukturuar në gjashtë kategori sipas problematikave të mëposhtme:

- (I) uji,
- (II) ajri,
- (III) ndotja akustike,
- (IV) hapësirat e gjelbëra,
- (V) menaxhimi i mbetjeve urbane dhe
- (VI) ndryshimet klimatike.

Nga ky pyetësor është synuar përmbushja e qëllimit të këtij studimi, njohja me perceptimin e qytetarëve mbi gjendjen e mjedisit në qytetet kryesore, shkaqet dhe sjelljen e tyre qytetare në përfshirjen në nismat vendore. Baza e pyetësoi është marrë nga anketa e realizuar po nga Milieukontakt dhe grupimi ECIM në vitin 2015 në vetëm 4 qytete (Krujë, Përmet, Sarandë dhe Librazhd) duke shtuar në të një seksion mbi ndryshimet klimatike dhe katastrofat natyrore, masat dhe planet e bashkive për t'iu adaptuar këtyre ndryshimeve. Në analizën e veçantë për çdo qytet janë marrë në konsideratë dhe rezultatet e vitit 2015, duke nxjerrë në pah përmirësimet apo përkeqësimet e gjendjes së mjedisit, falë edhe ndërhyrjeve apo projekteve të realizuara përgjatë mandatit të qeverisjes lokale (2015-2019).

Përveç plotësimit të alternativave të anketës, qytetarët kanë dhënë gjithashtu rekomandimet si edhe kanë shprehur kërkesat e tyre, të cilat i janë drejtuar deputetit të Njesisë së Qeverisjes Vendore. Anketat u realizuan përgjatë muajit korrik 2017, ndërsa hedhja dhe përpunimi i rezultateve u realizua përgjatë muajit gusht 2017.

III. Analiza e mostrës


Si mostër anketimi është zgjedhur forma e thjeshtë e rastit, e konceptuar në: a) gjini, b) arsimim, c) moshë, ç) vendbanim/lagje. Këta elementë sigurojnë një mostër të mjaftueshme dhe gjithëpërfshirëse për përgjigjet e mbledhura, të zotërueshme për objektin e hulumtimit, duke siguruar përfaqësimin cilësor dhe sasior të popullsisë, si dhe duke mbajtur nën kontroll konfliktin e interesit apo faktorëve negativ.

Nisur nga numri i popullsisë (sipas INSTAT, Censurit 2011) këto qytete kanë një numër prej afërsisht 364 mijë banorë dhe, mostra e marrë është mbi 1000 anketa, e cila:


- Siguron se karakteristikat e të intervistuarve dhe të mostrës së përzgjedhur për studim, përmbushin objektivat e studimit;
- Krijon besueshmërinë dhe efektivitetin e metodologjisë së përdorur;
- Qartëson problematikat e trajtuara për pjesëmarrësit në anketë;
- Merr përgjigjet e pyetësorëve të zhvilluar në komunitetin e 7 qyteteve;
- Ndhmon në analizën e gjetjeve për realizimin e raportit për të cilin u zhvillua anketimi.

IV. Rezultatet e sondazhit

Nga të dhënat e të anketuarve rezultoi se 523 persona janë të seksit femër dhe 477 të tjerë të seksit mashkull (grafiku 1). Nga të anketuarit 446 janë me arsim të mesëm, 428 me arsim të lartë dhe 126 vetë me arsim 9-vjeçar. (grafiku 2).




Grafiku 1: Të dhënat sipas gjinisë



Grafiku 2: Të dhënat sipas arsimit

Nga anketat rezultoi se 742 e të anketuarve e vlerësonin mjedisin si shumë të rëndësishëm dhe kryesisht nga qytetet Librazhd (97%), Elbasan (80%), Gramsh (77%), Krujë e Përmet me 73%. Ndërkohë 252 të anketuar e vlerësojnë mjaftueshëm të rëndësishëm (grafiku 3) dhe kryesisht qytetarët e Lezhës dhe Sarandës. Gjendjen e mjedisit gjatë këtyre 10 viteve të fundit 469 e të anketuarve e vlerësuan të përkeqësuar (konkretisht Përmeti me 80%, Saranda me 62% dhe Elbasani me 52%) dhe 358 e vlerësuan pozitivisht (konkretisht qytetet Gramsh, Librazhd, Lezhë dhe Krujë) grafiku 4.



Grafiku 3: Sa i rëndësishëm është mjedisi



Grafiku 4: Të dhëna për gjendjen e mjedisit

Problematikat mjedisore më shumë shqetësuese për të anketuarit ishin: a) ndotja e ujit (33.9%), b) ajrit (29.4%), c) mos menaxhimi i mbetjeve urbane (24.4%) , ç) hapësirat e gjelbra (20.3%) duke u ndjekur nga ndryshimet klimatike dhe ndotja akustike si problematikat e fundit më pak shqetësuese, tabela 1.





Tabela 1. Renditja e problematikave kryesore për mjedisin

Uji: Përsa i përket ujit të pijshëm 595 e të anketuarve pranonin se ai vjen me orare të reduktuara kryesisht qytetet Krujë (91%), Elbasan (82%), Përmet (80%) dhe Lezhë (73%), 379 tregojnë e të anketuarve se ka pasur ujë dhe kryesisht nga qytetet Librazhd (97%), Gramsh (67%) dhe


Sarandë. Ndërsa një numër shumë i vogël prej rreth 26 vetë ankohen se nuk ka pasur ujë fare. Lidhur me cilësinë e ujit, shumë i rëndësishëm për shëndetin 518 e të anketuarve mendojnë se



ai është i ndotur dhe pjesa më e madhe nga qytetet e Sarandës dhe Gramshit, 338 vetë si jo të ndotur dhe kryesisht qytetarët e Elbasanit dhe Librazhdit dhe 144 vetë nuk dinë asgjë për cilësinë e tij (grafiku 5). Shkaktarët kryesor për ndotjen e ujit u renditën: infrastruktura e degraduar (54.4%) e qyteteve Përmet, Elbasan, Gramsh dhe Krujë, keq menaxhimi i burimeve ujore (29.1%), ujërat e zeza (21.2%) kryesisht për qytetarët e Sarandës, arsye të tjera (5.1%) si faktor social (2.2%) dhe faktor ekonomik (0.9%),


Grafiku 5: A është uji i ndotur?

Ajri: Ndotja e ajrit ishte pjesa e dytë e anketës, ku rezultoi se 453 e të anketuarve pranojnë se ajri është i ndotur dhe kryesisht qytetarët e Elbasanit (96%), Krujës (75%) dhe Lezhës (71%), 449 vetë mendojnë se ajri s'është i ndotur dhe konkretisht qytetarët e Përmetit me 99%, Gramshit me 80% dhe Librazhdit me 78%. Ndërkohë 99 e të anketuarve nuk dinë asgjë nëse ajri përreth tyre është apo jo i ndotur (përmendim Lezhjanët me 80%). Ndër shkaqet e ndotjes së ajrit rezultatet e anketave tregojnë se industria është në vendi e parë si një nga ndotësit më të mëdhenj të ajrit (277 të anketuar). Qytetarët që ankohen më tepër nga guroret janë nga Saranda 60%, Kruja me 69% ndotje nga guroret dhe fabrikat e çimentos dhe Elbasani me ndotje që vjen nga fabrikat e çimentos, ferro kromi dhe uzinat e hekurit. Më pas vijnë makinat dhe trafiku (262 të anketuar) dhe djegia e mbetjeve me 119 vetë (grafiku 6).




Grafiku 6: Shkaktarët kryesor për ndotjen e ajrit

Ndotja akustike: 385 të anketuar mendojnë se s'ka zhurma në mjedisin që ata i rrethon dhe kryesisht nga qytete të vogla si Përmeti dhe Gramshi, 327 vetë ankohen se ka disi zhurma në qytete si Kruja (62%) dhe Librazhdi (41%). Ndërsa 288 të anketuar pranojnë faktin se ka zhurma shqetësuese (grafiku 7) dhe kryesisht të anketuarit vijnë nga qytetet e mëdha të Elbasanit (54%), Lezhës (53%) dhe Sarandës (40%). Shkaqet e zhurmave renditen sipas përqindjes: pothuaj gjysma e të anketuarve përmend zhurmat nga makinat dhe kryesisht qytete si Lezha, Elbasani dhe Kruja. Mungesa e hapësirave të gjelbra përmendet nga rreth 1/5 e të anketuarve dhe kryesisht nga banorë të Librazhdit me 68%, firmat e ndërtimit përmenden nga 174 vetë kryesisht nga Saranda dhe në vend të fundit janë lokalet e natës me 13.3% (grafiku 8).




Grafiku 7: A ka zhurma në mjedisin që ju rrethon?




Grafiku 8: Cilët janë shkaktarët kryesor të zhurmave

Hapësirat e gjelbra: Sipas anketave rezulton se 484 e të anketuarve (grafiku 9) mendojnë se hapësirat e gjelbra s'janë të mjaftueshme (qytetet e Sarandës dhe Elbasanit), 287 vetë mendojnë se janë disi të mjaftueshme (kryesisht gjysma e banorëve të anketuar në Librazhd) dhe 229 vetë mendojnë se hapësirat aktuale të gjelbra janë të mjaftueshme dhe kryesisht banorë nga Përmeti 95%, Gramshi e Lezha në 84% dhe Kruja me 55%. Hapësirat më shumë të përdorshme për vende shlodhje rezultuan: gjysma e të anketuarve përzgjedhën parkun publik (qytetarët e Përmetit, Krujës, Elbasanit, Librazhdit dhe Gramshit pranë të cilëve ka edhe Parqe Kombëtare), 367 vetë përzgjedhën sheshin para pallatit (kryesisht Lezhjanët) dhe 132 vetë trotuaret. Përsa i përket infrastrukturës së këtyre vendeve shlodhëse 612 të anketuar mendojnë se hapësirat e gjelbëra s'ofrojnë infrastrukturë të mirë (kryesisht banorë të Krujës dhe Librazhdit), ndërsa 388 vetë mendojnë se këto hapësira ofrojnë infrastrukturë të mirë për të qenë ambjente shlodhëse (grafiku 10). Këto të fundit vijnë kryesisht nga qytete si Përmeti (91%) dhe Gramshi (78%).




Grafiku 9: A janë të mjaftueshme hapësirat e gjelbëra?




Grafiku 10: A kanë infrastrukturën e nevojshme?

Mbetjet urbane: Menaxhimi i mbetjeve urbane në Shqipëri vazhdon të mbetet problem serioz, i cili kërkon ndërhyrje dhe veprime konkrete nga bashkitë përkatëse. Konkretisht në shtatë qytetet e anketuara prej Milileukontakt Shqipëri rezulton se: 845 qytetarë mendojnë se mbetjet urbane janë problem në qytetin e tyre (Kruja 81%, Elbasani 80%, Përmeti 70% dhe Lezha 63%) dhe 145 qytetarë mendojnë se s'janë problem (grafiku 11) ose thënë ndryshe realizohet kënaqshëm nga autoriteti vendor përkatës dhe konkretisht Gramshiotët (45%).

Pyetjes nëse kryhet ashtu siç duhet mbledhja e mbeturinave nga ana e bashkisë pak më shumë se gjysma e të anketuarve e pohojnë këtë gjë (kryesisht Përmeti, Librazhdi, Lezha dhe Elbasani), 239 vetë e pranojnë se ky shërbim s'kryhet fare nga ana e bashkisë dhe 171 qytetarë pohojnë se nuk mund të thonë asgjë në lidhje me këtë çështje (kryesisht nga Saranda dhe Kruja me 45% secila). Qytetarët janë shumë të interesuar për diferencimin e mbetjeve ku mbi 90% e tyre mendojnë se ky proces duhet kryer, 74 vetë mendojnë të kundërtën (grafiku 12).




Grafiku 10: A janë problem mbetjet në zonën tuaj?



Grafiku 11: A jeni të gatshëm për diferencimin e mbetjeve

Ndryshimet klimatike: Përgjigjet e qytetarëve në lidhje me ndryshimet klimatike dhe pasojat që sjellin ato janë: 420 të anketuar mendojnë se qytetet e tyre s'janë të rrezikuara nga katastrofat natyrore (qytetet si Librazhdi, Saranda, Gramshi dhe Elbasani), 300 vetë mendojnë se janë të rrezikuara nga këto katastrofa, kryesisht qytete si Lezha (81%) e Përmeti (88%) dhe 27.8% s'dinë asgjë për këtë çështje. Pyetjes, nëse qytetet e tyre janë prekur nga katastrofat natyrore këto 10 vitet e fundit qytetarët i janë përgjigjur: mendojnë se nuk ka pasur asnjë katastrofë natyrore 476 vetë, mendojnë se katastrofa kanë ndodhur 347 vetë dhe 177 të anketuar s'dinë gjë për këtë çështje.

Në raste katastrofash natyrore si përmbytje, zjarre, shkarje tektonike etj., Emergjencat Civile kanë funksion shumë të rëndësishëm, duke parandaluar rrezikun, mbajtur nën kontroll apo duke i dhënë zgjidhje përfundimtare situatave të krijuara. 450 qytetarët në lidhje me këtë shërbim tregojnë se s'dinë asgjë për Emergjencat Civile (kryesisht në Sarandë me 80%), 369 vetë mendojnë se ky shërbim e kryen me efektivitet punën e tij (kryesisht Përmeti dhe Librazhdi) dhe 181 qytetarë mendojnë se ky shërbim nuk kryhet me efektivitet (Grafiku 13). Kryesisht banorët e Lezhës kanë rezultuar më të pakënaqur me këtë shërbim me 53%.



Gjithashtu në raste katastrofash natyrore jo të gjitha bashkitë kanë një sistem të mirëfilltë paralajmërimi, edhe në rastet kur ai bëhet, s'është në kohë reale si edhe ka mungesë të theksuar informacioni. 889 qytetarë me përgjigjet e tyre në anketat tona treguan se qytetet e tyre kanë nevojë për një sistem paralajmërimi, 81 vetë s'dinë asgjë për këtë çështje dhe një numër shumë i vogël (31 vetë) mendojnë se qytetet e tyre s'kanë nevojë për sisteme paralajmërimi.

Grafiku 13: A kryhet me efektivitet puna nga Emergjencat Civile?

Një bashki është e suksesshme kur ajo arrin të menaxhojë në të gjitha nivelet katastrofat e ndryshme natyrore, ndaj për të përmirësuar dhe rritur angazhimin e punonjësve të bashkive qytetarët rekomandojnë:

- informim dhe përfshirje e tyre në raste të katastrofave mjedisore 64.4%;
- ndërgjegjësim mbi pasojat nga Ndryshimet Klimatike 30.1%.

Një pjesë shumë e rëndësishme e anketës së përgatitur nga Milieukontakt Shqipëri ishin gjithashtu kërkesat e qytetarëve drejtuar deputetit për përmirësimin e mjedisit ku më së shumti spikasnin:

- Shtimi i hapësirave të gjelbra;
- Ruajtja dhe mbrojtja e pyjeve;

- *Shtimi i hapësirave shlodhëse për të moshuarit dhe fëmijët;*
- *Rregullimi i infrastrukturës jo vetëm brenda qendrave të qyteteve por edhe jashtë tyre;*
- *Përmirësimi i infrastrukturës së ujit të pijshëm, kanalizimet e ndryshme apo ujërat e zeza;*
- *Ndërtimi i ujësjellësve të rinj aty ku është e nevojshme;*
- *Menaxhimi i mbetjeve urbane;*
- *Largimi i bagëtive nga zonat e banuara, krijimi i grupeve të vogla në periferi;*
- *Ndërtimi i fushave të ndryshme sportive;*
- *Mbyllja e guroreve pranë qendrave të banuara;*
- *Ruajtja dhe menaxhimi i zonave bregdetare;*
- *Eliminimi i zhurmave nga lokalet;*
- *Ndalimi i qarkullimit të makinave të vjetra që ndotin ajrin;*
- *Kontrolle të fabrikave për shkarkimet në ajër, tokë dhe ujë; Monitorim i shkarkimeve në ajër dhe vendosjes së filtrave në fabrika;*
- *Zhvillimin e infrastukturës dhe të turizmit.*

Gjetje dhe rekomandime

Nga vlerësimi i pyetësorëve del qartë që mjedisi urban edhe pse këto 10 vitet e fundit është përkeqësuar në nivel vendi përsëri mbetet një çështje shumë e rëndësishme ku fushat më prioritare mbeten uji i pijshëm, ajri dhe menaxhimi i mbetjeve. Gjendja shfaqet mjaft e rënduar

UJI

- Saranda dhe Gramshi

Bashkia duhet të ndërmarrë projekte dhe investime në fushën e përmirësimit të infrastrukturës së ujit të pijshëm, kanalizimet e ndryshme apo ujërat e zeza.

Airi

- Elbasani, Kruja dhe Lezha,

Bashkia duhet të vazhdojë përpjekjet për monitorimin e cilësisë së ajrit dhe sidomos të atyre bizneseve industriale që shkaktojnë ndotje përtje normave të lejuara si rezultat edhe i mospërdorimit të filtrave apo të teknologjisë më të mirë të vlefshme. Inspektorët e mjedisit në këto bashki të ndjekin nga afër raportet e vetëmonitorimit për shkarkimet në ajër, tokë dhe ujë. Për këtë duhet edhe një bashkëpunim më i mirë me drejtoritë rajonale të mjedisit dhe Inspektoriatin e Mjedisit. Mbetet detyrë parësore sidomos për Krujën mbylljen e guroreve apo aktiviteteve karrierë që janë shumë pranë zonave të banuara.

Zhurmat

- Elbasani, Lezha dhe Saranda

Këto qytete kanë shtim të zhurmave jo vetëm ditën por edhe natën si rezultat i transportit të rënduar. Kjo del e qartë dhe në raportet e gjendjes së mjedisit hartuar nga AKM ku ka një shtim mbi 4.5% krahasuar edhe me normat e OBSH. Ndaj nevojitet rregullimi i infrastrukturës jo vetëm brenda qendrave të qyteteve por edhe jashtë tyre (unazat përrethqytetase), shtimi i rrugëve pedonale apo qarkullimi me orare të kufizuara. Një masë tjetër e rëndësishme është dhe eliminimi i zhurmave nga lokalet gjatë sezonit të verës sidomos.

Mbetjet urbane

Të gjitha qytetet paraqiten me një nivel të ulët të menaxhimit të mbetjeve urbane. Pavarësisht se Lezha ka patur plan menaxhimi të mbetjeve, përsëri situata e mbetjeve është e pakënaqshme dhe iniciativat e ndarjes në burim të mbetjeve kanë mbetur në letër. Përmeti, Gramshi, Librazhdi e Kruja nuk ka ende një plan menaxhimi, kanë vendepozitime të cilat nuk plotësojnë kushtet e duhura inxhinjerike për mbrojtjen e mjedisit dhe janë subjekt i zjarreve të shpeshta. Gazrat e tymrat që clirohen prej tyre, jo vetëm ndotin ajrin, por helmojnë edhe tokën si dhe ujërat mbi e nëntokësore që rrjedhin pranë këtyre vend-depozitimeve. Përvec punës për ndërgjegjësimin e banorëve për reduktimin e mbetjeve dhe nxitjen e riciklimit bashkitë mund të marrin masa për përmirësimin e kushteve në vendepozitimet aktuale (sistemim, mbulim të herëpashershëm të mbetjeve për të shmangur djegien) si dhe të nxisin minimizimin e përdorimit të qeseve plastike përmes incentivave kufizuese.

Hapësirat e gjelbra

- Saranda e Elbasani

Hapësirat e gjelbëra janë të kufizuara dhe poshtë normave apo standarteve të BE dhe kur ato etiketohen si të tilla nuk ofrojnë infrastrukturë të mirë. Për këtë bashkitë përkatëse duhet të punojnë më shumë për shtimin e hapësirave shlodhëse për të moshuarit dhe fëmijët si në zonat e brendshme (nëpër lagje) por edhe të kurorave të gjelbra të qytetit. Kjo duhet shoqëruar dhe me ruajtjen dhe mbrojtjen e pyjeve. Saranda duke qënë dhe një qytet me turizëm të zhvilluar përgjatë pjesës më të madhe të vitit duhet të investojë në krijimin e një brezi të gjelbër i cili do të shërbejë si frenues i shpërhapjes urbane, do të rrisë cilësinë mjedisore dhe hapësirat e gjelbërta. Mbjelljet me pemë apo fidanë të rinj do të zbusin mjaft fenomenin e faqeve të zhveshura në hyrje të qytetit, por edhe përgjatë bregut.

Ndryshimet klimatike

- Lezha dhe Përmeti

Të dy këto qytete janë ndër më të prekurit nga katastrofat e ndryshme natyrore për shkak të vërshimeve të lumenjve. Situata të tilla janë përsëritur më shpesh në Lezhë, por përsëri banorët kanë nevojë për më shumë informim dhe përfshirje në raste të katastrofave mjedisore. Shumë e rëndësishme për të gjitha qytetet mbetet ndërgjegjësimi për pasojet nga ndryshimet klimatike të cilat janë edhe më të ndjeshme në zonat në zhvillim, apo ku edhe politika nuk bën investimet e

duhura. Bashkitë nga ana e tyre duhet të forcojnë sistemin e paralajmërimit dhe të Emergjencave Civile duke kërkuar edhe ndihmën e bizneseve vendase në kuadër të përgjegjshmërisë sociale.

Qyteti i Krujës

V.G Rezultatet e anketës për problematikat mjedisore në qytetin e Krujës

Të dhëna të përgjithshme:




Qyteti historik i Krujës ndodhet rreth 35 km larg nga Tirana. I njohur si “qyteti i bardhë” ai është ndërtuar në një lartësi mesatare 608 metra mbi nivelin e detit dhe kur koha është e kthjellët prej tij mund të shohësh bregdetin Adriatik nga Durrësi deri në derdhjen e Bunës.

I njohur më së shumti si kryeqendra e vendit tonë në mesjetë dhe si qyteti i heroit tonë kombëtar Skënderbeut, Kruja është një nga trevat më përfaqësuese në vendin tonë. Udhëtimi drejt Krujës ka disa

stacione të rëndësishme natyrore, arkeologjike dhe historike, Përveç kësaj aty zhvillojnë aktivitetin e tyre dhe disa industri. Për t’u përmendur janë industria e këpucëve, industria e nxjerrjes dhe përpunimit të gurit gëlqeror dhe fabrikave të çimentos. Prania e gropave të gëlqeres


në Krujë ka qenë një problem serioz prej vitesh jo vetëm për degradimin e mjedisit, shëndetin e njerëzve, por edhe për cilësinë e tyre të jetesës. Është e pamundur të udhëtosh për në Krujë e të mos vëresh zhdukjen e pyjeve të mrekullueshëm me pisha përgjatë rrugës. Jo pak raste janë raportuar, ankesa të banorëve për problemet me dëmtimet në muret e shtëpive/ dyqaneve, të cilat mendohet të vijnë nga vënia e dinamitit në karriera. E ndërsa disa familje krutane e kanë të vetmen mënyrë jetese punën në këto gurore, nuk ndodh




të jetë kështu me Fabrikat e çimentos. Projektuar sipas “standardeve evropiane”, këto fabrika jo vetëm që kanë mbjellë pakënaqësinë e banorëve për ndotjen e kryer, por ato janë bërë shpesh shkak i efekteve të tjera si, dëmtimi i ujësjetës dhe burimeve të ujit.² Në harkun kohor të një jave është plotësuar një numër i konsiderueshëm anketash nga qytetarët duke na mundësuar edhe neve përpunimin e të dhënave.

² Burimi: Raport “Zgjedhjet qendrore 2013. “Jepini Shqipërisë një zhvillim të qëndrueshëm!”, përgatitur nga rrjeti i vigjilencës mjedisore.

Për qytetin e Krujës rezultatet e anketës treguan: Në analizën e bërë nga 151 të anketuarit rezultojnë 53% femra dhe 47% meshkuj. Numri më i madh i të anketuarve ishte nga mosha 41-50 në masën 26.5%, ndër të cilët pjesa më e madhe janë me arsim të mesëm 43%, me arsim të lartë 34% dhe me 9-vjeçare janë 23% (grafiku 1,2).




Grafiku 1. Të dhënat sipas moshës Krujë




Grafiku 2. Të dhënat sipas arsimit

Të anketuarit, banorë të qytetit të Krujës, 74% e tyre e vlerësojnë shumë të rëndësishëm mjedisin dhe 26% mjaftueshëm të rëndësishëm. Ata mendojnë se gjendja e mjedisit në 10 vitet e fundit është përqësuar (55%), 20% e tyre s'dinë gjë për këtë çështje dhe 1/4 mendojnë se ai është përmirësuar. Çështjet më të rëndësishme mjedisore, por dhe më shumë shqetësuese ishin problematikat në cilësinë e ajrit dhe ndotjen e tij në vend të parë me 24% së bashku me mungesën e hapësirave të gjelbra dhe ndryshimet klimatike në rend të fundit (10%), grafiku 4.



Grafiku 3: Rëndësia e mjedisit problematikave kryesore




Grafiku 4: Renditja e

Ndotja e ujit: Situata aktuale për ujin e pijshëm paraqitet problematike. Qytetarët e Krujës pranojnë se uji i pijshëm mungon dhe vjen me orare të reduktuara, 91% e tyre e pranojnë këtë dhe 6% thonë se uji vjen rregullisht (grafiku 5). Arsyeja e ndotjes së ujit të pijshëm është infrastruktura e degraduar (51%), keqmenaxhimi i burimeve ujore (23%) dhe (18%) ujërat e zeza (grafiku 6). Në vitin 2015 është hartuar po një pyetësor dhe duke i krahasuar me shifrat e marra nga analiza e rezultateve në vitin 2017, vëmë re se situata e furnizimit me ujë është përkeqësuar, pasi kemi një rritje me 6% të mungesës së ujit të pijshëm, nga 84.3% në vitin 2015 ka vajtur në 91% në vitin 2017.




Grafiku 5: Situata e ujit të pijshëm në Krujë




Grafiku 6: Shkaku kryesor për ndotjen e ujit të pijshëm

Ndotja e ajrit: Nga analiza e bërë rezulton se cilësia e ajrit në Krujë nuk është në kushtet normale, pasi 75% e të anketuarve janë të vetëdijshëm se ajri në qytetin e tyre është i ndotur; ndërsa 25% mendojnë që nuk është i ndotur ose nuk kanë informacion (grafiku 7).



Grafiku 7: Ndotja e ajrit




Grafiku 8: Shkaku kryesor për ndotjen e ajrit


Ndotja e ajrit në këtë qytet vjen si pasojë e djegies së gomave për përfitimin e gurit gëlqeror, nga industria e çimentos, nxjerrja e gurit dhe inerteve (69%), si edhe nga shkarkimet e gazrave nga makinat 18% (grafiku 8). Krahasuar me vitin 2015 ku ndotja e ajrit vlerësohej në 65% si e tillë, në 2017 kjo vlerë rritet me 10%, pra shkon në masën 75%.

Ndotja e akustike: Disi e mirë paraqitet situata nga ndotja akustike, ku nga 62% prej të anketuarve pranojnë se qyteti ka pak zhurma dhe, në rastet kur ka zhurma (27%) ajo vjen nga lëvizja e makinave dhe trafiku i rënduar (grafiku 9 dhe 10).

Sa i takon vitit 2015 zhurmat rezultonin në nivelin 50%, në vitin 2017 kjo vlerë shkon në 62%, pra kemi një rritje me 10%. Kjo rritje vjen sepse trafiku në qytet është devijuar, pasi po kryhen punime për rehabilitimin e qendrës së qytetit.



Grafiku 9. Ndotja nga zhurmat




Grafiku 10. Shkaktarët e ndotjes akustike

Hapësirat të gjelbëra: Sa i përket hapësirave të gjelbëra qytetarët e Krujës janë relativisht të kënaqur, pasi mund të shfrytëzojnë parqet publike dhe sheshet para pallateve. 55% e qytetarëve mendojnë se hapësirat e gjelbëra janë të mjaftueshme ndërsa 43% e tyre pranojnë të kundërtën (Grafiku 11). Si ambiente shlodhëse qytetarët përdorin parkun publik (62%), sheshin para pallatit (38%), po jo me infrastrukturë të përshtatshme për t'u shlodhur dhe argëtuar pasi 93% e qytetarëve janë të këtij mendimi (Grafiku 12). Në vitin 2015 situata paraqitej krejt ndryshe pasi kishte shumë pak hapësira të gjelbra dhe vetëm 32.3% e qytetarëve pranonin se ka mjaftueshëm hapësirë të gjelbër. Ky ndryshim ka ardhur falë ndërhyrjeve që janë kryer në lagjen nr.1 dhe nr.4, pasi janë krijuar sheshe pushimi me gjelbërim mes pallateve për qytetarët.




Grafiku 11: Hapësirat e gjelbëra




Grafiku 12: Ambientet shlodhëse

Mbetjet urbane: Ashtu si edhe cilësia e ajrit, problematike paraqitet edhe menaxhimi i mbetjeve të ngurta urbane, ku 81% e të anketuarve mendojnë kështu (grafiku 13) e të anketuarve mendojnë se mbetjet janë disi problem për qytetin e tyre; kur në vitin 2015, 53% e të anketuarve e kanë pranuar këtë fakt. Qytetarët vlerësojnë punën e kryer nga Bashkia për mbledhjen në mënyrë të rregullt të mbetjeve urbane të këtij qyteti me 45% dhe po 45% e tyre nuk kanë informacionin e duhur nëse ky shërbim kryhet si duhet. Situata mbetet pothuaj e njëjtë me atë të vitit 2015 ku 48% e qytetarëve u shprehën se bashkia e kryen mbledhjen e mbetjeve rregullisht. Qytetarët shprehen të gatshëm të fillojnë të mbledhin mbeturinat plastike, letrën, metalin veçmas nga mbeturinat e tjera nëse bashkia i'ua kërkon (grafiku 14). Në qoftë se bëjmë një krahasim me analizën e kryer në vitin 2015, rezulton se mbetjet urbane shfaqeshin problematike në masën 36.4%, pra më shumë shqetësuese krahasuar me vitin 2017, ku jemi në vlerat 12% të marra nga përgjigjet që dhanë qytetarët.




Grafiku 13: Problematika me mbetjet urbane



Grafiku 14: Rëndësia e diferencimit të mbetjeve

Ndryshimet klimatike: Çështja e fundit e trajtuar në pyetësor, por jo për nga rëndësia ishte katastrofat natyrore/ teknologjike, ku si shqetësim kryesor qytetarët kishin zjarret në pyje dhe prerjen e tyre pa kriter. 48% e tyre shprehën se në 10 vitet e fundit ata janë kanë hasur problematika të shkaktuara nga katastrofat natyrore, ku 31% mendojnë se ka patur të tilla, ndërsa 21% nuk kanë dëgjuar për këto fenomene (grafiku 15).



Grafiku 15: Situata nga katastrofat natyrore

Për menaxhimin e këtyre katastrofave rekomandohet informim dhe përfshirje e qytetarëve me 48%, si edhe ndërgjegjësim mbi pasojat që mund të ndodhin pothuajse në të njëjtat vlera 46% (tabela 1).

Informim dhe përfshirje të qytetarëve në raste katastrofash mjedisore	48%
Ndërgjegjësim mbi pasojat nga Ndryshimet Klimatike	46%
Tjetër	4%

Tabela 1. Rekomandime për menaxhimin e katastrofave natyrore.

Në përfundim të anketës, qytetarët e Krujës shprehën edhe kërkesat që mund t'ia drejtojnë Kryetarit të Bashkisë, ku mund të përmendim si më kryesore:

- Parqe publike dhe gjelbërim për fëmijët e të rriturit;
- reduktimin e ndërtimeve pa kriter të pallateve;
- mbrojtjen e biodiversitetit me qëllim shtimin e turizmit;
- të ndërhyjë tek fabrikat që të ketë kontrolle për shkarkimet në ajër, tokë dhe ujë;
- kontrollin e cilësisë së makinave, vitet e prodhimit;
- mbylljen e gropave të gëlqeres që djegin ende goma;
- më shumë ujë të pijshëm në qytet;
- zhvillimin e infrastrukturës dhe të turizmit;
- mbrojtja e pyjeve të Krastës nga zjarret dhe ruajtjen e pyjeve.